



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA RREGULLATORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 18842 prot.

Vlorë, më 20. 11 2024

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2024

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA
DJEGIA E BANESËS TË Z.ËNGJËLL MEMAJ DHE SHPËRBLIMIN FINANCIAR
NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

VENDOSI:

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z. Ëngjëll Memaj, e ndodhur në lagjen “Isa Boletini”, Rajoni Nr. 2, Bashkia Vlorë, në datën 13.09.2024, sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

A. 67.897 (gjshtëdhjet e shtatë mij e tetëqint e nëntëdhjet e shtatë) lekë për punime ndërtimi (135.795x50%).



B. 359.526(treqind e pesëdhjet e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e gjashtë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake.

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015,neni 55 pika .

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA RREGULLATORE
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 18842 prot.

Vlorë, më 20.11 2024

RELACION

PËR

PROJEKT-VENDIMIN “MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z. ËNGJËLL MEMAJ DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORE “

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë datë 03.08.2024 ka paraqitur kërkesën z.Ëngjell Memaj me nr.12461prot. për shkakë të djegies së banesës e ndodhur në lagjen “Isa Boletini” Rajoni 2, Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr.15 datë 12.01.2024 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë ,shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të procesverbalit të konstatimit të gjendjes së banesës në datë 12.08.2024, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.12461/1 prot, datë 13.09.2024 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të z. Ëngjell Memaj në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.12461/2 prot, datë 26.09.2024 “Dërgim dokumentacioni për banesën e djegur të z.Ëngjell Memaj ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

- Vlera e dëmeve në banesën e z. Ëngjëll Memaj është 427.423 (katërqind e njëzetë e shtatë mijë katërqind e njëzetë e tre) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjet për banesat e djegura.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e z. Ëngjëll Memaj sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile të Bashkisë Vlorë.

DREJTOR

Dorian Demiri

